



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Tiranë, më 22.11.2019

Nr. 26 Prot.

Lënda: Dërgohet vendim nr.236 datë 14.11.2019 i KLP "Për renditjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm".

KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Z. GRAMAZ RUÇI

KRYETAR

TIRANË

I nderuar Z.Ruçi,

Në mbështetje të nenit 148/a pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë", ligjit nr .97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"; Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në mbledhjen e tij të datës 14.11.2019 ka miratuar vendimin nr.236 "Për renditjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm". Me mbarimin e afatit të ankimimit më datë 21.11.2019, rezultoi se asnjë nga kandidatët në këtë proces nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit.

Për sa më sipër në bazë të nenit 34 dhe 35, të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", si dhe të nenit 21 pika 6 të Rregullores "Për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë"; bashkëlidhur Ju përcjellim vendimin nr.236 datë 14.11.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe relacionin shpjegues, si pjesë përbërëse të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin

KRYETARI
GËNT IBRAHIMI

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga "Qemal Stafa" Nr. 1, godina e Prokurorisë së Përgjithshme, Tiranë

www.klp.al/ adresa e mail: info@klp.al



RELACION SHPJEGUES MBI VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË PËR RENDITJEN E KANDIDATËVE PËR PROKUROR TË PËRGJITHSHËM

I

FAZAT NË TË CILAT KA KALUAR PROCESI I VLERËSIMIT DHE RENDITJES SË KANDIDATËVE

Procesi i vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, i zhvilluar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kaluar në disa faza si më poshtë:

- KLP, me Vendimin nr. 50, datë 19.03.2019, miratoi Rregulloren “Për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë”, e cila është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 44, datë 29.03.2019 dhe ka hyrë në fuqi në të njëjtën datë.
- Me hyrjen në fuqi të Rregullores, më datë 29.03.2019, KLP ka shpallur njoftimin për shprehjen e interesit për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë. Në përfundim të afatit 30 ditor, pranë KLP-së u regjistruan 4 (katër) kandidatë që shprehën interesin për këtë pozicion dhe më datë 29.04.2019, KLP publikoi në faqen e tij zyrtare emrat e kandidatëve, konkretisht:
 - Arta Marku
 - Fatjona Memçaj
 - Lulzim Alushaj
 - Olsian Çela
- Me Urdhrin nr. 32, datë 18.06.2019, të Kryetarit të KLP-së, u ngrit një grup pune për administrimin e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët dhe nga institucionet në kuadër të vlerësimit të tyre, me përbërjen e mëposhtme:
 - Kosta Beluri;
 - Nurihan Seiti;
 - Vatë Staka.
- Pas verifikimit të plotësisht të kushteve ligjore nga ana e kandidatëve, KLP, me vendim nr. 169, datë 25.9.2019 vendosi ndalimin e kandidimit të z. Lulzim Alushaj për



pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm.

- Ndaj vendimit të mësipërm të KLP u ushtrua ankim në Gjykatën Administrative të Apelit nga ana e z. Alushaj.
- Me vendim nr. 232 (86-2019-3173) datë 25.10.2019 Gjykata Administrative e Apelit vendosi rrëzimin e padisë së z. Alushaj, në këtë mënyrë vendimi nr. 169 datë 25.9.2019 mbeti në fuqi.
- Me vendim nr. 228, datë 29.10.2019, KLP vendosi miratimin e listës me emrat e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të cilët plotësojnë kushtet ligjore pas verifikimit paraprak. Konkretisht kandidatët zyrtarë të miratuar me këtë vendim janë:
 - Arta Marku
 - Fatjona Memçaj
 - Olsian Çela
- Me vendim nr.229, datë 12.11.2019, Këshilli miratoi metodologjinë orientuese për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm.
- Në mbledhjen e datës 12.11.2019, anëtarët e Këshillit diskutuan rastet e mundshme të pengesave ligjore dhe të konfliktit të interesave. Këshilli vlerësoi (jo në mënyrë unanime) se asnjë nga anëtarët nuk gjendet në këto kushte, kështu që të gjithë anëtarët mund të vijojnë të jenë pjesë e vlerësimit për kandidatët.
- Në datën 13.11.2019 KLP organizoi seancat dëgjimore me kandidatët zyrtarë. Këto seanca u transmetuan drejtpërdrejt në televizion si dhe u ndoqën në sallë nga të ftuar, vëzhgues vendas dhe të huaj si dhe një numër gazetarësh. Në seancat dëgjimore morën pjesë përfaqësues të misioneve OPDAT dhe EURALIUS, të cilët u drejtuan pyetje kandidatëve.
- Në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 14.11.2019 përfundoi procesi i vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë.

II

BAZA LIGJORE

Për realizimin e këtij procesi KLP ka zbatuar aktet ligjore dhe nënligjore si më poshtë:



- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”
- Rregullorja “Për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë”
- Metodologjia lidhur me vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm

III

KRITERET DHE NËNKRITERET PËR VLERËSIMIN E KANDIDATËVE

Siç u theksua më sipër, procesi i vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve u realizua në përputhje me parashikimet e Kushtetutës, Ligjit nr. 97/2016, rregullores dhe metodologjisë orientuese. Për të arritur në vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve, të gjithë anëtarët e Këshillit kanë patur në dispozicion dosjet e kandidatëve të cilat përmbanin dokumentacionin e dorëzuar prej tyre në momentin e aplikimit, dokumentacionin dhe informacionin e dërguar nga institucionet e ndryshme sipas kërkesës së KLP si dhe dokumentacionin shtesë të paraqitur nga kandidatët në përputhje me rregulloren.

Kriteret e vlerësimit për secilin kandidat, të parashikuara në Rregullore dhe të zbatuara në vlerësim nga anëtarët e Këshillit janë:

1. Integriteti/ aftësia profesionale
2. Integriteti moral
3. Aftësitë organizative dhe drejtuese
4. Elemente shtesë për vlerësim

Secili prej kriterëve/komponentëve të vlerësimit ka disa nënkritere.

Kriteri i aftësisë profesionale është zbërthyer në 5 nënkritere:

3



- kohëzgjatja dhe përshtatshmëria e përvojës në punë me pozicionin për të cilin konkurren (1 - 5 pikë);
- rezultatet e vlerësimeve profesionale ose etike të kandidatëve në pozicionet e mëparshme, nëse ka, ose rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën e drejtësisë penale. (1 - 5 pikë);
- rezultatet e arritura gjatë studimeve të larta gjatë trajnimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, si dhe pjesëmarrja në trajnimin vazhdues dhe në kurse trajnimi të certifikuar në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë (1 - 3 pikë);
- rezultatet e arritura gjatë studimeve pasuniversitare në fushën e së drejtës penale (1 - 3 pikë);
- Punime akademike, studime shkencore, shkrime dhe ligjërata profesionale, botime, pjesëmarrje në aktivitete shkencore, pjesëmarrje në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional i kandidatit gjatë 5 viteve të fundit në fushën e të drejtës. (1 - 4 pikë).

Ky kriter sipas parashikimeve në rregullore vlerësohet me minimumi 5 pikë dhe maksimumi 20 pikë.

Kriteri i integritetit moral është zbërthyer në 2 nënkritere:

- reputacioni që kandidati gëzon në shoqëri dhe tek kolegët, si rezultat i aktivitetit të tij profesional bazuar në cilësitë morale si ndershmëria, përpikmëria në kryerjen e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve dhe llogaridhënia (1 - 2 pikë);
- reputacioni që kandidati gëzon në shoqëri dhe tek kolegët, si rezultat i aktiviteteve të kryera gjatë kohës që nuk ushtron funksionin e tij bazuar në cilësitë morale si besueshmëria, paanshmëria, dinjiteti, veprimtaritë sociale ose kulturore (1 - 2 pikë).

Ky kriter sipas parashikimeve në rregullore vlerësohet me minimumi 2 pikë dhe maksimumi 4 pikë.

Kriteri lidhur me aftësitë organizative dhe drejtuese të kandidatëve është zbërthyer në 5 nënkritere:

- cilësia e platformës dhe vizionit që ata paraqesin (1 - 5 pikë)



- aftësitë e provuara në marrjen e vendimeve dhe përgjegjësi, bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore (1 - 5 pikë);
- aftësitë në komunikim (1 - 4 pikë);
- aftësia për të punuar në grup dhe në mjedise multidisiplinare dhe/ose multikulturore (1 - 3 pikë);
- aftësia për përfaqësim në publik (1 - 3 pikë).

Ky kriter sipas parashikimeve në rregullore vlerësohet me minimumi 5 pikë dhe maksimumi 20 pikë.

Së fundmi, në rregullore janë parashikuar edhe **elementë shtesë për vlerësim të cilat zbërthehen si më poshtë:**

- Mbajtja e titujve akademikë (1 pikë për çdo titull deri në 2 pikë totali);
- Studimet dhe trajnimet afatgjata të kryera jashtë vendit jo më pak se dy javë në fushën e së drejtës penale ose menaxheriale (deri në 2 pikë);
- Zotërimi i gjuhëve të huaja duke i dhënë përparësi gjuhëve zyrtare të Këshillit të Evropës:
 - i. Për çdo gjuhë të huaj, të cilën kandidati e njih shumë mirë, vlerësohet me 1 pikë;
 - ii. Për çdo gjuhë të huaj, të cilën kandidati e njih në nivel pune, vlerësohet me 0.5 pikë.

Ky kriter sipas parashikimeve në rregullore vlerësohet me maksimumi 6 pikë.

Nisur nga sa më sipër, **secili kandidat mund të vlerësohet me deri në 50 pikë nga secili anëtar** i Këshillit, pra në total **secili kandidat mund të vlerësohet me maksimumi 550 pikë.**



IV MASA E PËRMBUSHJES PËR SECILIN KRITER NGA ÇDO KANDIDAT

Në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 14.11.2019 përfundoi procesi i vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë.

Në përfundim të procesit, anëtarët e Këshillit kanë plotësuar formularët e vlerësimit sipas shtojcave përkatëse të Rregullores. Vlerësimi në mënyrë krahasimore i kandidatëve lidhur me secilin kriter paraqitet si më poshtë:

Nr	Kriteri/nënkriteret	Kandidati Arta Marku	Kandidati Fatjona Memçaj	Kandidati Olsian Çela
1	AFTËSITË PROFESIONALE <ul style="list-style-type: none">- Kohëzgjatja dhe rëndësia/përshtatshmëria e eksperiencës në punë me pozicionin në të cilin konkurron- Rezultatet e vlerësimeve profesionale ose etike të kandidatëve në pozicionet e mëparshme, nëse ka ose rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën e drejtësisë penale.- Rezultatet e arritura gjatë studimeve të tyre të larta, gjatë trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm në Shkollën e Magjistraturës, si dhe në kurse trajnimi të certifikuara në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë.	181 pikë nga 220 ose 82,27%	167 pikë nga 220 ose 75,91 %	191 pikë nga 220 ose 86,82 %

	<ul style="list-style-type: none"> - Rezultatet e arritura gjatë studimeve pasuniversitare në fushën e së drejtës penale - Punime akademike, studime shkencore, shkrime dhe ligjërata profesionale, botime, pjesëmarrje në aktivitete shkencore, pjesëmarrje në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional i kandidatit gjatë 5 viteve të fundit në fushën e të drejtës. 			
2	<p>INTEGRITETI MORAL</p> <ul style="list-style-type: none"> - Reputacioni që kandidati gëzon në shoqëri dhe tek kolegët, si rezultat i aktivitetit të tij profesional bazuar në cilësitë morale, si: ndershmëria, përpikmëria në kryerjen e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, llogaridhënia. - Reputacioni që kandidati gëzon në shoqëri dhe tek kolegët, si rezultat i aktiviteteve të kryera gjatë kohës që nuk ushtron funksionin e tij bazuar në cilësitë morale si besueshmëria, paanshmëria, dinjiteti, aktivitete bamirëse ose kulturore. 	<p>38 pikë nga 44 ose 86,36 %</p>	<p>29 pikë nga 44 ose 65,91 %</p>	<p>38 pikë nga 44 ose 86,36 %</p>
3	<p>AFTËSITË ORGANIZATIVE</p>	<p>161 pikë nga 220 ose 73,18 %</p>	<p>134 pikë nga 220 ose 60,91 %</p>	<p>190 pikë nga 220 ose 86,36 %</p>

7



	<ul style="list-style-type: none">- Cilësia e platformës dhe vizionit- Aftësitë e provuara në marrjen e vendimeve dhe përgjegjësi, bazuar gjithashtu në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore.- Aftësitë në komunikim- Aftësia për të punuar në grup dhe në mjedise multidisiplinare dhe/ose multikulturore.- Aftësia për përfaqësim në publik.			
4	ELEMENTË SHITESË <ul style="list-style-type: none">- Mbajtja e titujve akademikë- Studimet dhe trajnimet afatgjata të kryera jashtë vendit jo më pak se dy javë në fushën e së drejtës penale ose menaxheriale (deri në 2 pikë);- Zotërimi i gjuhëve të huaja duke i dhënë përparësi gjuhëve zyrtare të Këshillit të Evropës:	26 pikë nga 66 ose 39.39 %	32 pikë nga 66 ose 48,48 %	40 pikë nga 66 ose 60,61 %
	Totali	406 pikë nga 550 ose 73.82 %	362 pikë nga 550 ose 65.81 %	459 pikë nga 550 ose 83.45 %

V

VLERËSIMI DHE RENDITJA PËRFUNDIMTARE E KANDIDATËVE

Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve dhe renditja e tyre paraqitet si më poshtë:



1. Olsian ÇELA gjithësej 459 pikë
2. Arta MARKU gjithësej 406 pikë
3. Fatjona MEMÇAJ gjithësej 362 pikë

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETARI
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
ARBEN DOLLAPAJ

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
BESNIK CANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 236, Datë 14.11.2019

PËR RENDITJEN E KANDIDATËVE PËR PROKUROR TË PËRGJITHSHËM

Në bazë të nenit 148/a të Kushtetutës, të nenit 166, pika 2 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, të nenit 23, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të Rregullores “Për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Bazuar në rezultatet e vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në Ligj dhe në Rregulloren e cituar më lartë, kandidatët renditen si më poshtë:
 - 1) Olsian Çela (459 pikë)
 - 2) Arta Marku (406 pikë)
 - 3) Fatjona Memçaj (362 pikë)
2. Relacioni shpjegues, i cili argumenton renditjen bazuar në rezultatet e vlerësimit të kriterëve sipas nenit 23 të Ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” si dhe të Rregullores “Për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë” nga anëtarët e Këshillit, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të njoftohet me këtë vendim Znj. Arta Marku, Znj. Fatjona Memçaj dhe Z. Olsian Çela.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI

GENT IBRAHIMI



ZV/KRYETAR

ALFRED BALLA



ANËTAR

KOSTAQ BELURI

ANËTAR

BUJAR SHESHI

ANËTAR

NURIHAN SEITI

ANËTAR

SANDËR BECI

ANËTAR

VATË STAKA

ANËTAR

TARTAR BAZAJ

ANËTAR

ARBEN DOLLAPAJ

ANËTAR

ESMERALDA KESHI

ANËTAR

BESNIK CANI